

PROCESVERBAL
nga seanca e 4-ët e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 01.03.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA_së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr.Emilija Janevska, mr.Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunoviq, Maja Damevska, Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: Përfaqësues të mediave të TV SHUTEL Shkup – Antonie Stojçeski, Radio ALEKSANDAR MAKEDONSKI Kërçovë – Ilija Tanevski dhe Radio USKANA-PLUS Kërçovë – Ilir Mehdiu.

Z. Petrushevski hapi seancën e 4-ët publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 15:30 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Z. Ajdini, për arsye teknike në lidhjen me video-konferencë është përfshirë vetëm përmes lidhjes audio.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, (votimi i z. Ajdini ishte përmes lidhjes audio), me 6 vota “pro”, miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Arsyetim nga TV SHUTEL Shkup, për veprimin e medias në lidhje me procedurën e iniciuar për heqjen e lejes.
2. Arsyetim nga Radio ALEKSANDAR MAKEDONSKI Kërçovë, për veprimin e medias në lidhje me procedurën e iniciuar për heqjen e lejes.
3. Arsyetim nga Radio USKANA-PLUS Kërçovë, për veprimin e medias në lidhje me procedurën e iniciuar për heqjen e lejes.
4. Arsyetim nga HIT Radio Shkup, për veprimin e medias në lidhje me procedurën e iniciuar për heqjen e lejes.

5. Të ndryshme.

Z. Petrushevski shpjegoi se kjo seancë është pararendëse e seancës së ardhshme ku Këshilli do të votojë nëse mediave në fjalë do t'i hiqet apo jo leja. Në seancat publike të Këshillit, Ligji ofron mundësinë që transmetuesit të japin arsyetimin e tyre lidhur me procedurën e nisur më parë për heqjen e lejes.

Z. Trajçevski shpjegoi se afati i RA Uskana për pagesën e kompensimit vjetor të lejes skadon për dy ditë. Por duke qenë se dy ditët në vijim janë e shtunë dhe e diel, afati kalohet në ditën tjetër të punës, pra të hënën. Ai deklaroi se Agjencia dhe Këshilli ndaj të gjithë transmetuesve kanë të njëtin tretman në lidhje me afatin e fundit për pagesë dhe propozoi që Pika nr.3 – Arsyetimi nga Radio USKANA-PLUS Kërçovë, për veprimin e medias në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes, të shtyhet për ditën e hënë, datë 04.03.2024, së bashku me nënpikën nga Pika 4 nga seanca e 8-të e ardhshme, që i referohet RA Uskanës.

Z. Petrushevski deklaroi se propozimi është i pranueshëm, para së gjithash sepse kështu Këshilli ka vepruar dhe me RA HIT Shkup, kur ka pasur mundësi ligjore për pagesë edhe për një ditë, dhe pika është shtyrë. Në pajtim me diskutimin, sugjeroi që Pika 3 e seancës së 4-ët publike dhe propozimi për heqjen e lejes të RA Uskanës si nënpikë e pikës 4 të shtyhen për të hënën, 04.03.2024.

Këshilli nuk kishte kundërshtim për këtë propozim.

Përfaqësuesi i Radio USKANA-PLUS Kërçovë, në pajtim me diskutimin është shkëputur nga lidhja video-konferencë.

Pika 1

Arsyetim nga TV SHUTEL Shkup, lidhur me veprimin e medias në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes:

Përfaqësuesi nga TV Shutel, z.Antonie Stojçeski, falënderoi për mundësinë që të marrë pjesë në seancë dhe t'i drejtohet Këshillit për të shpjeguar gjendjen reale me mediumin. Ai bën të ditur se sot kanë bërë pagesë sipas faturës së dorëzuar përmes një subjekti tjetër për shkak se llogaria e TV Shutel është e bllokuar. Për këtë arsye u janë kthyer mjetet. Ai shpjegoi se janë në negociata me SHMDMA dhe beson se sot deri në fund të ditës do të bien dakord për pëlqimin për zhblokimin e llogarisë. Nëse SHMDMA miraton, të hënën llogaria do të zhblokohet dhe ata do të mund të paguajnë kompensimin vjetor nga llogaria e TV Shutel. Ai për TV Shutel tha se është media e vetme në gjuhën rome dhe maqedonase në vendin tonë, ndoshta i vetmi në rajonin dhe më gjerë ku do të ishte turp i madh nëse do të shuhej(mbyllej). Ai kërkoi mirëkuptim dhe kërkoi mundësinë e shtyrjes së afatit që të mund të paguajnë mjetet nga llogaria e tyre.

Z. Petrushevski shpjegoi se marrja e vendimit të Këshillit, përkatësisht marrja e vendimit do të jetë në seancën e radhës.

Pika 2

Sqarim nga Radio ALEKSANDAR MAKEDONSKI Kërçovë, lidhur me veprimin e medias në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes:

Përfaqësuesi i RA ALKSANDAR MAKEDONSKI nga Kërçova, z. Ilija Tanveski shpjegoi se u ka dërguar shkresë gjatë javës anëtarëve të Këshillit dhe drejtorit Trajçevski, së bashku me një kopje të pagesës së kryer të kompensimit vjetor për leje. Por ai tha se mjetet i janë kthyer sepse janë paguar nga një llogari tjetër, dhe jo nga llogaria e radios. Ai ka shpjeguar se kjo situatë ka ardhur për shkak të bllokimit të llogarisë së mediumit. Ai informoi se radioja ka më shumë se 29 vite në transmetim dhe ka kërkuar mundësi që të gjendet zgjidhje që të mos i hiqet leja. Ai theksoi se llogaria e transmetuesit është bllokuar nga 4 subjekte, por janë vazhdimisht në negociata për të mënjeluar pengesat. Ai falënderoi Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale që i ka dhënë mundësi më të madhe për pagesë, por kërkoi afat shtesë prej 15 ditësh për të arritur të zhblokojnë llogarinë dhe të bëjnë pagesën e lejes nga llogaria e tyre. Për gjendjen në të cilën ndodhet radio, ai ka shpjeguar se kjo është për shkak të mungesës së informacionit për ndryshimet në ligj, pasi sektori i tyre i kontabilitetit nuk i ka njoftuar për ndryshimet (të rejat) se nuk mund të bëhet pagesë me çesion apo si person fizik.

Z. Petrushevski tha se marrja e vendimit dhe qëndrimi i Këshillit do të jetë i njëjtë për të gjitha mediat. Ai ka shpjeguar se Ligji nuk jep mundësi për prolongimin (shtyrjen) e afatit, por diskutimi për këtë temë do të lihet për seancën e radhës.

Pika 3

Arsyetimi nga Radio USKANA-PLUS Kërçovë, për veprimin e medias në lidhje me procedurën e iniciuar për heqjen e lejes, është shtyrë për vazhdimin e seancës së 4-ët publike, e cila do të mbahet të hënën, më 04.03.2024.

Pika 4

Nuk kishte përfaqësues të pranishëm nga HIT Radio Shkupi.

Pika 5

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**